



## **LIGJ**

**Nr.10 027, datë 11.12.2008**

### **PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN PËR MBROJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE NËNUJORE, PARIS 2001**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

## **KUVENDI**

### **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

#### **VENDOSI:**

#### **Neni 1**

Republika e Shqipërisë aderon në konventën për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore, bërë në Paris më 2 nëntor 2001.

#### **Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5978, datë 29.12.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,**

**Bamir Topi**

## KONVENTË

### MBI MBROJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE NËNUJORE

#### UNESCO

**Paris, 2 nëntor 2001**

Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara;

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara, që u mbledh në Paris nga 15 tetori deri më 3 nëntor 2001, në sesionin e saj të 31-të,

duke njohur rëndësinë e trashëgimisë kulturore nënujore si pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore të njerëzimit dhe një element veçanërisht i rëndësishëm në historinë e popujve, kombeve dhe marrëdhënieve të tyre me njëri-tjetrin në lidhje me trashëgiminë e tyre të përbashkët;

e ndërgjegjshme për rëndësinë e mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore nënujore dhe që përgjegjësia për këtë u takon të gjitha shteteve;

duke vënë re interesin publik dhe vlerësimin publik në rritje të trashëgimisë kulturore nënujore;

e bindur për rëndësinë e kërkimit, informimit dhe arsimit për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore nënujore;

e bindur për të drejtën e publikut të gëzojë përfitimet edukative dhe çlodhëse të aksesit të përgjegjshëm paqësor në trashëgiminë kulturore nënujore in situ dhe të vlerës së edukimit publik për të kontribuar në ndërgjegjësimin, vlerësimin dhe mbrojtjen e kësaj trashëgimie;

e ndërgjegjshme për faktin që trashëgimia kulturore nënujore kërcënohet nga aktivitetet e paautorizuara drejtuar asaj dhe për nevojën për masa më të forta për t'i parandaluar këto aktivitete;

e ndërgjegjshëm për nevojën për t'iu kundërpërgjigjur rregullisht ndikimit të mundshëm negativ mbi trashëgiminë kulturore nënujore të aktiviteteve legjitime që mund të ndikojnë rastësisht mbi të;

e shqetësuar thellë nga shfrytëzimi tregtar në rritje i trashëgimisë kulturore nënujore dhe veçanërisht nga aktivitetet që synojnë shitjen, përftimin ose këmbimin e trashëgimisë kulturore nënujore;

e ndërgjegjshme për praninë e teknologjisë së përparuar që lehtëson zbulimin dhe aksesin te trashëgimia kulturore nënujore;

duke besuar që bashkëpunimi ndërmjet shteteve, organizatave ndërkombëtare, institucioneve shkencore, organizatave profesionale, arkeologëve, zhytësve, palëve të tjera të interesuara dhe publikut të gjerë është thelbësor për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore;

duke marrë në konsideratë që studimi, zbulimi dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore nënujore kërkojnë praninë dhe zbatimin e metodave shkencore dhe përdorimin e teknikave dhe pajisjeve të përshtatshme, si dhe një shkallë të lartë të specializimit profesional, ku të gjitha tregojnë nevojën për kritere rregulluese të unifikuara;

duke ditur nevojën për të kodifikuar dhe gradualisht zhvilluar rregulla në lidhje me mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore nënujore në pajtim me të drejtën dhe praktikën ndërkombëtare, duke përfshirë konventën e UNESCO-s mbi mjetet e ndalimit dhe shmangien e importit, eksportit dhe transferimit të paligjshëm të pronësisë kulturore të datës 14 nëntor 1970, konventën e UNESCO-s për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore botërore të datës 16 nëntor 1972 dhe konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtën e detit të datës 10 dhjetor 1982;

e angazhuar për të përmirësuar efektivitetin e masave të niveleve ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare për ruajtjen in situ ose, nëse është e nevojshme për qëllime shkencore ose mbrojtëse, rikuperimin e kujdesshëm të trashëgimisë kulturore nënujore;

pas vendimit të sesionit të njëzet e nëntë që kjo çështje duhet të bëhet objekt i një konvente ndërkombëtare,

miraton në këtë ditë të dytë të nëntorit 2001 këtë Konventë.

## **Neni 1**

### **Përkufizime**

Për qëllimet e Konventës:

**1.a)** "Trashëgimia kulturore nënujore" nënkupton të gjitha gjurmët e ekzistencës njerëzore që kanë një karakter kulturor, historik ose arkeologjik që kanë qenë pjesërisht ose plotësisht nën ujë, periodikisht ose vazhdimisht, për të paktën 100 vjet, si:

i) vendet, strukturat, ndërtesat, veglat e punës dhe mbetjet njerëzore, së bashku me kontekstin e tyre arkeologjik dhe natyror;

ii) anijet, avionët ose mjete të tjera, ose pjesë të tyre, ngarkesa e tyre ose përmbajtje të tjera, së bashku me kontekstin e tyre arkeologjik dhe natyror; dhe

iii) objektet e karakterit parahistorik.

b) Tubacionet dhe kabllot e vendosura në shtratin detar nuk konsiderohen si trashëgimi kulturore nënujore.

c) Instalimet e ndryshme nga tub acionet dhe kabllot, të vendosura në shtratin detar dhe që vazhdojnë të përdoren, nuk konsiderohen trashëgimi kulturore nënujore.

2.a) "Shtetet palë" nënkupton shtetet që kanë rënë dakord t'i nënshtrohen kësaj Konvente dhe për të cilët kjo Konventë është në fuqi.

b) Kjo Konventë zbatohet mutatis mutandis në ato territore që përmenden në nenin 26, paragrafi 2(b), që bëhen palë në këtë Konventë në pajtim me kushtet e parashikuara në atë paragraf dhe në masën që "Shtetet palë" u referohet atyre territoreve.

3. "UNESCO" nënkupton Organizatën Arsimore, Shkencore dhe Kulturore të Kombeve të Bashkuara.

4. "Drejtor i Përgjithshëm" nënkupton Drejtorin e Përgjithshëm të UNESCO-s.

5. "Zona" nënkupton shtratin detar dhe fundin e oqeanit dhe nëntokën e tyre, tej kufijve të juridiksionit kombëtar.

6. "Aktivitetet me objekt trashëgiminë kulturore nënujore" nënkupton aktivitetet që kanë trashëgiminë kulturore nënujore si objektin e tyre kryesor dhe që, drejtpërdrejt ose jo, cenojnë fizikisht ose ndryshe dëmtojnë trashëgiminë kulturore nënujore.

7. "Aktivitetet që ndikojnë rastësisht mbi trashëgiminë kulturore nënujore" nënkupton aktivitetet që, pavarësisht se nuk e kanë trashëgiminë kulturore nënujore si objektin e tyre kryesor ose një prej objekteve të tyre, mund të cenojnë fizikisht ose ndryshe dëmtojnë trashëgiminë kulturore nënujore.

8. "Anije dhe avionë shtetërorë" nënkupton luftanijet dhe anije të tjera ose avionë që kanë qenë në pronësi ose operuar nga një shtet dhe që, në momentin e fundosjes, përdorëshin vetëm për qëllime qeveritare jotregtare, që janë identifikuar si të tilla dhe përmbushin përkufizimin e trashëgimisë kulturore nënujore.

9. "Rregullat" nënkupton rregullat në lidhje me aktivitetet me objekt trashëgiminë kulturore nënujore, siç përmendet në nenin 33 të kësaj Konvente.

## **Neni 2**

### **Objektiva dhe parime të përgjithshme**

1. Kjo Konventë synon të forcojë mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore.

2. Shtetet Palë bashkëpunojnë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore.

3. Shtetet Palë ruajnë trashëgiminë kulturore nënujore në të mirë të njerëzimit në pajtim me dispozitat e kësaj Konvente.

4. Shtetet Palë, individualisht ose së bashku sipas rastit, marrin të gjitha masat e përshtatshme, në pajtim me këtë Konventë dhe të drejtën ndërkombëtare, që janë të nevojshme për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore, duke përdorur për këtë qëllim mjetet më të mira praktike që disponojnë dhe në pajtim me aftësitë e tyre.

5. Ruajtja in situ e trashëgimisë kulturore nënujore konsiderohet si opsioni i parë para lejimit ose përfshirjes në çdo aktivitet të drejtuar te kjo trashëgimi.

6. Trashëgimia kulturore nënujore e përfshirë depozitohet, konservohet dhe menaxhohet në një mënyrë që siguron ruajtjen e saj afatgjatë.

7. Trashëgimia kulturore nënujore nuk shfrytëzohet për arsye tregtare.

8. Në pajtim me praktikën e shtetit dhe të drejtën ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtën e detit, asgjë në këtë Konventë nuk interpretohet sikur ndryshon rregullat e së drejtës ndërkombëtare dhe praktikën e shtetit në lidhje me imunitetet e sovranitetit, as dhe të drejtat e shtetit në lidhje me mjetet e lundrimit dhe të fluturimit të shtetit.

9. Shtetet Palë sigurojnë që mbetjeve njerëzore, të cilat gjenden në ujërat detare t'u kushtohet respekti i duhur.

10. Hyrja e përgjegjshme pa dëmtuar ose dokumentimi in situ i trashëgimisë kulturore nënujore inkurajohet për të krijuar ndërgjegjësimin, vlerësimin dhe mbrojtjen nga publiku të trashëgimisë, përveç rasteve kur ky mundësim është në kundërshtim me mbrojtjen dhe menaxhimin e tij.

11. Asnjë veprim ose aktivitet i ndërmarrë mbi bazën e kësaj Konvente nuk përbën shkak për të pretenduar, kundërshtuar ose ankimuar ndonjë pretendim për sovranitet ose juridiksion kombëtar.

### **Neni 3**

#### **Raporti ndërmjet kësaj Konvente dhe Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të drejtën e detit**

Asgjë në këtë Konventë nuk cenon të drejtat, juridiksionin dhe detyrat e shteteve sipas së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtën e detit. Kjo Konventë interpretohet dhe zbatohet në kontekstin dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, duke përfshirë konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtën e detit.

### **Neni 4**

#### **Raporti me të drejtën e shpëtimit dhe të drejtën e gjetjeve**

Çdo aktivitet, në lidhje me trashëgiminë kulturore nënujore ku zbatohet kjo Konventë, nuk i nënshtrohet së drejtës së shpëtimit ose së drejtës së gjetjeve, përveçse kur:

- a) është i autorizuar nga autoritetet kompetente;
- b) është në pajtim të plotë me Konventën; dhe
- c) siguron që përftimi i trashëgimisë kulturore nënujore arrin mbrojtjen e tij maksimale.

## **Neni 5**

### **Aktivitetet që rastësisht ndikojnë trashëgiminë kulturore nënujore**

Secili Shtet Palë përdor mjetet më të mira praktike që disponon për të parandaluar ose lehtësuar ndikimet negative që mund të lindin nga aktivitetet nën juridiksionin e tij, që ndikojnë rastësisht në trashëgiminë kulturore nënujore.

## **Neni 6**

### **Marrëveshjet dypalëshe, rajonale ose marrëveshje të tjera shumëpalëshe**

- 1.** Shtetet Palë inkurajohen të hyjnë në marrëveshje dypalëshe, rajonale ose marrëveshje të tjera shumëpalëshe ose të zhvillojnë marrëveshjet ekzistuese, për ruajtjen e trashëgimisë kulturore nënujore. Të gjitha këto marrëveshje janë në pajtim të plotë me dispozitat e kësaj Konvente dhe nuk dobësojnë karakterin e saj ndërkombëtar. Shtetet, në këto marrëveshje, mund të miratojnë rregulla dhe rregullore që do të siguronin një mbrojtje më të mirë të trashëgimisë kulturore nënujore se ato të miratuara në këtë Konventë.
- 2.** Palët në këto marrëveshje dypalëshe rajonale dhe marrëveshje të tjera shumëpalëshe mund të ftojnë shtetet me një lidhje të verifikueshme, veçanërisht një lidhje kulturore, historike ose arkeologjike, në trashëgiminë kulturore nënujore përkatëse të futen në këto marrëveshje.
- 3.** Kjo Konventë nuk ndryshon të drejtat dhe detyrimet e Shteteve Palë në lidhje me mbrojtjen e mjeteve të fundosura të lundrimit, që rrjedhin nga marrëveshjet dypalëshe rajonale ose marrëveshje të tjera shumëpalëshe të lidhura para miratimit të saj, dhe veçanërisht, ato që janë në pajtim me qëllimin e kësaj Konvente.

## **Neni 7**

### **Trashëgimia kulturore nënujore në ujërat e brendshme, ujërat arkipelagjike dhe detin territorial**

- 1.** Shtetet Palë, në ushtrim të sovranitetit të tyre, kanë të drejtën ekskluzive të rregullojnë dhe autorizojnë aktivitetet e drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore në ujërat e tyre të brendshme, ujërat arkipelagjike dhe detin territorial.
- 2.** Pa cenuar marrëveshjet e tjera ndërkombëtare dhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore, Shtetet Palë kërkojnë që rregullat të

zbatohen për aktivitetet e drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore në ujërat e tyre të brendshme, ujërat arkipelagjike dhe detin territorial.

**3.** Brenda ujërave të tyre arkipelagje dhe detit territorial, në ushtrim të sovranitetit të tyre dhe në njohje të praktikës së përgjithshme ndërmjet shteteve, Shtetet Palë, me qëllim bashkëpunimin për metodat më të mira për mbrojtjen e mjeteve të lundrimit dhe fluturimit të shteteve, duhet të njoftojë Shtetin e flamurit Palë në këtë Konventë dhe, sipas rastit, shtetet e tjera me një lidhje të verifikueshme, veçanërisht një lidhje kulturore, historike ose arkeologjike, në lidhje me zbulimin e këtij mjeti lundrimi ose fluturimi të identifikueshëm të shtetit.

## **Neni 8**

### **Trashëgimia kulturore nënujore në zonën e afërt**

Pa cenuar dhe përveç neneve 9 dhe 10 dhe në pajtim me nenin 303, paragrafi 2 i konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të drejtën e detit, Shtetet Palë mund t'i rregullojnë dhe autorizojnë aktivitetet e drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore brenda zonës së tyre të afërt. Për ta bërë këtë, ata kërkojnë që të zbatohen rregullat.

## **Neni 9**

### **Raportimi dhe njoftimi në zonën ekskluzive ekonomike dhe në shelfin kontinental**

**1.** Të gjitha Shtetet Palë kanë përgjegjësi për të ruajtur trashëgiminë kulturore nënujore në zonën ekonomike ekskluzive dhe në shelfin kontinental në pajtim me këtë Konventë.

Për pasojë:

a) një Shtet Palë mund të kërkojë që nëse një shtetas i tij ose një mjet lundrimi me flamurin e tij, zbulon ose synon të përfshihet në aktivitete të drejtuara në trashëgiminë kulturore nënujore që ndodhet në zonën e tij ekskluzive ekonomike ose në shelfin e tij kontinental, shtetasi ose kapiteni i mjetit lundrues duhet t'ia raportojë atij këtë zbulim ose aktivitet;

b) në zonën ekonomike ekskluzive ose në shelfin kontinental të një Shteti tjetër Palë:

i) Shtetet Palë kërkojnë që shtetasi ose kapiteni i mjetit lundrues ta raportojë këtë zbulim ose aktivitet tek ata dhe tek ai Shtet tjetër Palë;

ii) nga ana tjetër, një Shtet Palë i kërkon shtetasit ose kapitenit të mjetit lundrues ta raportojë këtë zbulim ose aktivitet dhe të sigurojë transmetimin e shpejtë dhe efektiv të këtyre raporteve te Shtetet e tjera Palë.

**2.** Me depozitimin e instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, një Shtet Palë deklaron mënyrën në të cilën raportet do të transmetohen sipas paragrafit 1(b) të këtij neni.

3. Një Shtet Palë njofton Drejtorin e Përgjithshëm për zbulimet ose aktivitetet e raportuara atij, sipas paragrafit 1 të këtij neni.

4. Drejtori i Përgjithshëm u ofron menjëherë të gjitha Shteteve Palë çdo informacion që i njoftohet atij, sipas paragrafit 3 të këtij neni.

5. Çdo Shtet Palë mund t'i deklarojë Shtetit Palë në zonën ekskluzive ekonomike ose në shelfin kontinental të të cilit gjendet trashëgimia kulturore nënujore, interesin e tij për t'u konsultuar si të sigurojë mbrojtjen efektive të asaj trashëgimie kulturore nënujore. Një deklaram i tillë bazohet në një lidhje të verifikueshme, veçanërisht në një lidhje kulturore, historike ose arkeologjike, ndaj trashëgimisë kulturore nënujore përkatëse.

## **Neni 10**

### **Mbrojtja e trashëgimisë kulturore nënujore në zonën ekskluzive ekonomike dhe në shelfin kontinental**

1. Nuk jepet asnjë autorizim për një aktivitet drejtuar ndaj trashëgimisë kulturore nënujore që gjendet në zonën ekskluzive ekonomike ose në shelfin kontinental, përveçse në pajtim me dispozitat e këtij neni.

2. Një Shtet Palë në zonën ekonomike ekskluzive të të cilit ose në shelfin kontinental të të cilit gjendet trashëgimia kulturore nënujore ka të drejtën të ndalojë ose autorizojë çdo aktivitet që drejtohet ndaj kësaj trashëgimie për të parandaluar ndërhyrjen te të drejtat ose juridiksionin e tij sovran sipas parashikimit nga e drejta ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtën e detit.

3. Nëse ka një zbulim të trashëgimisë kulturore nënujore ose synohet që ai aktivitet do të drejtohet ndaj trashëgimisë kulturore nënujore në një zonë ekonomike ekskluzive të një Shteti Palë ose në shelfin e tij kontinental, ai Shtet Palë:

a) konsultohet me të gjitha Shtetet e tjera Palë që kanë deklaruar interes sipas nenit 9, paragrafi 5, si të mbrohet më mirë trashëgimia kulturore nënujore;

b) bashkërendon këto konsultime si "Shteti bashkërendues", përveçse kur ai deklaron shprehimisht që nuk dëshiron ta bëjë këtë, dhe në këtë rast Shtetet Palë që kanë deklaruar interes sipas nenit 9, paragrafi 5 emërojnë një shtet bashkërendues.

4. Pa cenuar detyrën e të gjitha Shteteve Palë për ta mbrojtur trashëgiminë kulturore nënujore nëpërmjet të gjitha masave praktike të marra në pajtim me të drejtën ndërkombëtare për të parandaluar rrezikun e menjëhershëm ndaj trashëgimisë kulturore nënujore, duke përfshirë grabitjet, shteti bashkërendues mund të marrë të gjitha masat praktike, dhe/ose nxjerrë çdo autorizim të nevojshëm në pajtim me këtë Konventë dhe, nëse është e nevojshme para bisedimeve, të parandalojë çdo rrezik të menjëhershëm ndaj trashëgimisë kulturore nënujore, që rrjedh nga aktivitetet njerëzore ose çdo shkak tjetër, duke përfshirë grabitjen. Në marrjen e këtyre masave, mund të kërkohet asistencë nga Shtetet e tjera Palë.



## **5. Shteti bashkërendues:**

a) zbaton masat e mbrojtjes për të cilat është rënë dakord nga shtetet konsultuese, që përfshijnë shtetin bashkërendues, përveçse kur shtetet konsultuese që përfshijnë shtetin bashkërendues, bien dakord që një Shtet tjetër Palë do t'i zbatojë këto masa;

b) nxjerr të gjitha autorizimet e nevojshme për këto masa të rëna dakord në pajtim me rregullat, përveçse kur shtetet konsultuese që përfshijnë shtetin bashkërendues, bien dakord që një Shtet tjetër Palë do t'i nxjerrë ato autorizime;

c) mund të kryejë çdo kërkim paraprak të nevojshëm në trashëgiminë kulturore nënujore dhe nxjerr të gjitha autorizimet e nevojshme për këtë dhe njofton menjëherë Drejtorin e Përgjithshëm për rezultatet që nga ana tjetër ua ofron këtë informacion menjëherë Shteteve të tjera Palë.

**6.** Në bashkërendimin e konsultimeve, marrjen e masave, kryerjen e kërkimit paraprak dhe/ose nxjerrjen e autorizimeve në pajtim me këtë nen, shteti bashkërendues vepron në emër të Shteteve Palë si një të tërë dhe jo në interes të vet. Çdo veprim i tillë nuk përbën në vetvete një bazë për të konfirmuar ndonjë të drejtë preferenciale ose juridiksionale që nuk është e parashikuar në të drejtën ndërkombëtare, duke përfshirë konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtën e detit.

**7.** Në pajtim me dispozitat e paragrafëve 2 dhe 4 të këtij neni, asnjë aktivitet drejtuar ndaj mjeteve lundruese ose fluturuese të shtetit nuk mund të kryhet pa pëlqimin e shtetit të flamurit dhe bashkëpunimin e shtetit bashkërendues.

## **Neni 11**

### **Raportimi dhe njoftimi në zonë**

**1.** Shtetet Palë kanë përgjegjësi për ta ruajtur trashëgiminë kulturore nënujore në zonë në pajtim me këtë Konventë dhe nenin 149 të konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të drejtën e detit. Kështu, nëse një shtetas ose një mjet lundrimi që ka flamurin e një Shteti Palë zbulon ose synon të përfshihet në aktivitete të drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore në zonë, ai Shtet Palë kërkon që shtetasi i tij ose kapiteni i mjetit lundrues t'ia raportojë atij këtë zbulim ose aktivitet.

**2.** Shtetet Palë njoftojnë Drejtorin e Përgjithshëm dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Autoritetit Ndërkombëtar të Shtratit Detar për këto zbulime dhe aktivitete që u raportohen atyre.

**3.** Drejtori i Përgjithshëm u bën të ditur menjëherë të gjitha Shteteve Palë çdo informacion të dhënë nga Shtetet Palë.

**4.** Çdo Shtet Palë mund t'i deklarojë Drejtorit të Përgjithshëm interesin e tij për t'u konsultuar si të sigurohet mbrojtja e efektshme e trashëgimisë kulturore nënujore. Kjo deklaratë bazohet në një lidhje të verifikueshme me trashëgiminë kulturore nënujore përkatëse, ku u kushtohet rëndësi veçanërisht të drejtave preferenciale të shteteve me origjinë kulturore, historike ose arkeologjike.

## Neni 12

### Mbrojtja e trashëgimisë kulturore nënujore në zonë

1. Asnjë autorizim nuk jepet për aktivitetet e drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore që gjendet në zonë, përveçse në pajtim me dispozitat e këtij neni.
2. Drejtori i Përgjithshëm fton të gjitha Shtetet Palë që kanë deklaruar interes sipas nenit 11, paragrafi 4, të konsultohen si të mbrojnë më mirë trashëgiminë kulturore nënujore, dhe ta caktojnë një Shtet Palë për t'i bashkërenduar këto konsultime si "Shteti bashkërendues". Drejtori i Përgjithshëm fton gjithashtu Autoritetin Ndërkombëtar të Shtratit Detar për të marrë pjesë në këto konsultime.
3. Të gjitha Shtetet Palë mund të marrin të gjitha masat praktike në pajtim me këtë Konventë, nëse është e nevojshme para konsultimeve, për të parandaluar çdo rrezik të menjëhershëm ndaj trashëgimisë kulturore nënujore, qoftë nga aktiviteti i njeriut apo nga një shkak tjetër duke përfshirë grabitjet.
4. Shteti bashkërendues:
  - a) zbaton masat e mbrojtjes që janë rënë dakord nga shtetet konsultuese, që përfshijnë shtetin bashkërendues, përveçse kur shtetet konsultuese, që përfshijnë shtetin bashkërendues, bien dakord që këto masa do t'i zbatojë një Shtet tjetër Palë; dhe
  - b) nxjerr të gjitha autorizimet e nevojshme për këto masa të rëna dakord në pajtim me këtë Konventë, përveçse kur shtetet konsultuese, që përfshijnë shtetin bashkërendues, bien dakord që një Shtet tjetër Palë i nxjerr ato autorizime.
5. Shteti bashkërendues mund të kryejë çdo kërkim paraprak të nevojshëm në trashëgiminë kulturore nënujore dhe nxjerr të gjitha autorizimet e nevojshme për këtë dhe njofton menjëherë Drejtorin e Përgjithshëm për rezultatet që nga ana tjetër ua bën të ditur këtë informacion Shteteve të tjera Palë.
6. Për bashkërendimin e konsultimeve, marrjen e masave, zhvillimin e kërkimit paraprak, dhe/ose nxjerrjen e autorizimeve në pajtim me këtë nen, shteti bashkërendues vepron në të mirë të njerëzimit si një i tërë, në emër të Shteteve Palë. Vëmendje e rëndësishme u kushtohet të drejtave preferenciale të shteteve me origjinë kulturore, historike ose arkeologjike në lidhje me trashëgiminë kulturore nënujore përkatëse.
7. Asnjë Shtet Palë nuk ndërmerr apo autorizon aktivitete drejtuar ndaj mjeteve të lundrimit dhe fluturimit në zonë pa pëlqimin e shtetit të flamurit.

## **Neni 13**

### **Imuniteti sovran**

Luftanijet dhe anijet e tjera qeveritare ose avionët luftarakë me imunitet sovran, të operuara për qëllime jotregtare, që zhvillojnë operacione në mënyrën e tyre normale dhe nuk përfshihen në aktivitete që drejtohen ndaj trashëgimisë kulturore nënujore nuk janë të detyruara të raportojnë zbulimet e trashëgimisë kulturore nënujore sipas neneve 9, 10, 11 dhe 12 të kësaj Konvente. Megjithatë, Shtetet Palë sigurojnë, nëpërmjet miratimit të masave të përshtatshme që nuk cenojnë operacionet ose aftësinë operative të luftanijeve të tyre ose anijeve të tjera qeveritare ose avionëve luftarakë me imunitet sovran që operohen jo për qëllime tregtare, që ata të respektojnë, në masën që është e arsyeshme dhe praktike, nenet 9, 10, 11 dhe 12 të kësaj Konvente.

## **Neni 14**

### **Kontrolli i hyrjes në territor, trajtimi dhe zotërimi**

Shtetet Palë marrin të gjitha masat për të parandaluar hyrjen në territorin e tyre, trajtimin ose zotërimin e trashëgimisë kulturore nënujore të eksportuar në mënyrë të paligjshme dhe/ose të rikuperuar, nëse rikuperimi ka qenë në kundërshtim me këtë Konventë.

## **Neni 15**

### **Mospërdorimi i zonave nën juridiksionin e Shteteve Palë**

Shtetet Palë marrin masa për të ndaluar përdorimin e territorit të tyre, duke përfshirë portet detare, si dhe ishujt artificialë, instalimet dhe strukturat nën juridiksionin dhe kontrollin e tyre ekskluziv në mbështetje të çdo aktiviteti të drejtuar ndaj trashëgimisë kulturore nënujore që nuk është në pajtim me këtë Konventë.

## **Neni 16**

### **Masat në lidhje me shtetasit dhe mjetet e lundrimit**

Shtetet Palë marrin të gjitha masat praktike për të siguruar që shtetasit e tyre dhe mjetet e lundrimit me flamurin e tyre të mos përfshihen në asnjë aktivitet të drejtuar ndaj trashëgimisë kulturore nënujore në një mënyrë që nuk është në pajtim me këtë Konventë.

## **Neni 17**

### **Sanksionet**

**1.** Secili Shtet Palë vendos sanksione për shkeljen e masave që ai ka marrë për zbatimin e kësaj Konvente.

2. Sanksionet e zbatueshme në lidhje me shkeljet do të kenë ashpërsi të përshtatshme për të qenë të efektshme për të siguruar përputhjen me këtë Konventë dhe për të penguar shkeljet kurdoherë që të ndodhin dhe për t'u hequr shkelësve përfitimet që rrjedhin nga aktivitetet e tyre të paligjshme.

3. Shtetet Palë bashkëpunojnë për të siguruar ekzekutimin e sanksioneve të caktuara sipas këtij neni.

## **Neni 18**

### **Sekuestrimi dhe disponimi i trashëgimisë kulturore nënujore**

1. Secili Shtet Palë merr të gjitha masat që sigurojnë sekuestrimin e trashëgimisë kulturore nënujore në territorin e tij që është përfshirë në një mënyrë jo në pajtim me këtë Konventë.

2. Secili Shtet Palë regjistron, mbron dhe merr të gjitha masat e arsyeshme për të stabilizuar trashëgiminë kulturore nënujore të sekuestruar sipas kësaj Konvente.

3. Secili Shtet Palë njofton Drejtorin e Përgjithshëm dhe çdo shtet tjetër me një lidhje të verifikueshme, veçanërisht një lidhje kulturore, historike ose arkeologjike me trashëgiminë kulturore nënujore përkatëse për çdo sekuestrim të trashëgimisë kulturore nënujore që ka bërë sipas kësaj Konvente.

4. Një Shtet Palë që ka sekuestruar trashëgimi kulturore nënujore siguron që disponimi i saj të jetë në të mirë të publikut, duke marrë parasysh nevojën për konservim dhe kërkim; nevojën për ribashkimin e koleksionit të shpërndarë; nevojën për aksesin e publikut, ekspozimin dhe edukimin; dhe interesat e çdo shteti me një lidhje të verifikueshme, veçanërisht një lidhje kulturore, historike dhe arkeologjike, në lidhje me trashëgiminë kulturore nënujore përkatëse.

## **Neni 19**

### **Bashkëpunimi dhe njoftimi i informacionit**

1. Shtetet Palë bashkëpunojnë dhe ndihmojnë njëri-tjetrin në mbrojtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore nënujore sipas kësaj Konvente, duke përfshirë, sipas rastit, bashkëpunimin në hetimin, nxjerrjen, dokumentimin, konservimin, studimin dhe prezantimin e kësaj trashëgimie.

2. Në masën që përputhet me qëllimet e kësaj Konvente, secili Shtet Palë merr përsipër ta bëjë të ditur informacionin Shteteve të tjera Palë në lidhje me trashëgiminë kulturore nënujore, duke përfshirë zbulimin e trashëgimisë, vendndodhjen e trashëgimisë, trashëgiminë e nxjerrë ose përfshirë në kundërshtim me këtë Konventë ose përndryshe duke shkelur të drejtën ndërkombëtare, metodologjinë dhe teknologjinë shkencore përkatëse dhe zhvillimet ligjore në lidhje me këtë trashëgimi.

**3.** Informacioni i bërë i ditur ndërmjet Shteteve Palë ose ndërmjet UNESCO-s dhe Shteteve Palë në lidhje me zbulimin ose vendndodhjen e trashëgimisë kulturore nënujore, në masën që është në pajtim me legjislacionin e tyre të brendshëm, mbahet konfidencial dhe i rezervuar për autoritetet kompetente të Shteteve Palë nëse deklarimi i këtij informacioni do të rrezikonte ose përbënte rrezik për ruajtjen e kësaj trashëgimie kulturore nënujore.

**4.** Secili Shtet Palë merr të gjitha masat praktike për të shpërndarë informacion, duke përfshirë, sipas rastit, nëpërmjet bazave ndërkombëtare të përshtatshme të të dhënave në lidhje me trashëgiminë kulturore nënujore të nxjerrë ose përfutur në kundërshtim me këtë Konventë ose ndryshe në shkelje të së drejtës ndërkombëtare.

## **Neni 20**

### **Ndërgjegjësimi publik**

Secili Shtet Palë merr të gjitha masat praktike për të rritur ndërgjegjësimin publik në lidhje me vlerën dhe rëndësinë e trashëgimisë kulturore nënujore dhe rëndësinë e mbrojtjes së saj sipas kësaj Konvente.

## **Neni 21**

### **Trajnimi në arkeologjinë nënujore**

Shtetet Palë bashkëpunojnë në sigurimin e trajnimit në arkeologjinë nënujore, në teknikat e konservimit të trashëgimisë kulturore nënujore dhe sipas termave të rëna dakord, në transferimin e teknologjisë në lidhje me trashëgiminë kulturore nënujore.

## **Neni 22**

### **Autoritetet kompetente**

**1.** Me qëllim që të sigurohet zbatimi i përshtatshëm i kësaj Konvente, Shtetet Palë themelojnë autoritete kompetente ose përforcojnë ekzistuesit, sipas rastit, me qëllim ngritjen, mirëmbajtjen dhe përditësimin e një inventari të trashëgimisë kulturore nënujore, ruajtjen, konservimin, prezantimin dhe menaxhimin e efektshëm të trashëgimisë kulturore nënujore, si dhe kërkimin dhe edukimin.

**2.** Shtetet Palë i komunikojnë Drejtorit të Përgjithshëm emrat dhe adresat e autoriteteve të tyre kompetente në lidhje me trashëgiminë kulturore nënujore.

## **Neni 23**

### **Mbledhjet e Shteteve Palë**

- 1.** Drejtori i Përgjithshëm thërret një mbledhje të Shteteve Palë brenda një viti nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente dhe pas kësaj të paktën një herë në dy vjet. Me kërkesë të një shumice të Shteteve Palë, Drejtori i Përgjithshëm thërret një mbledhje të jashtëzakonshme të Shteteve Palë.
- 2.** Mbledhja e Shteteve Palë vendos në lidhje me funksionet dhe përgjegjësitë e saj.
- 3.** Mbledhja e Shteteve Palë miraton rregullat e saj të procedurës.
- 4.** Mbledhja e Shteteve Palë ngre një organ këshillues shkencor dhe teknik, të përbërë nga ekspertë të emëruar nga Shtetet Palë, duke i kushtuar rëndësi të veçantë parimit të shpërndarjes së drejtë gjeografike dhe preferencës së balancës gjinore.
- 5.** Organi këshillimor shkencor dhe teknik ndihmon rregullisht mbledhjen e Shteteve Palë në çështjet e natyrës shkencore dhe teknike në lidhje me zbatimin e rregullave.

## **Neni 24**

### **Sekretariati i Konventës**

- 1.** Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për funksionet e sekretariatit të kësaj Konvente.
- 2.** Detyrat e sekretariatit përfshijnë:
  - a)** organizimin e mbledhjeve të Shteteve Palë sipas parashikimit në nenin 23, paragrafi 1; dhe
  - b)** ndihmesën e Shteteve Palë në zbatimin e vendimeve të mbledhjeve të Shteteve Palë.

## **Neni 25**

### **Zgjidhja paqësore e mosmarrëveshjeve**

- 1.** Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë Shteteve Palë, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e Konventës u nënshtrohet negociatave në mirëbesim ose mjeteve të tjera paqësore për zgjidhjen sipas zgjedhjes së tyre.
- 2.** Nëse këto negociata nuk e zgjidhin mosmarrëveshjen brenda një afati të arsyeshëm kohor, ajo mund t'i paraqitet UNESCO-s për ndërmjetësim, me marrëveshje ndërmjet Shteteve Palë të interesuara.
- 3.** Nëse ndërmjetësimi nuk fillon ose nëse nuk ka zgjidhje me ndërmjetësim, dispozitat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që gjenden në pjesën XV të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtën e detit zbatohet mutatis mutandis për çdo mosmarrëveshje ndërmjet Shteteve Palë

në këtë Konventë në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, pavarësisht nëse ata janë Palë në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtën e detit.

**4.** Çdo procedurë e zgjedhur nga një Shtet Palë në këtë Konventë dhe në konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtën e detit në pajtim me nenin 287 të kësaj të fundit zbatohet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas këtij neni, përveçse kur ai Shtet Palë, në momentin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë Konventë ose në çdo moment pas kësaj, zgjedh një procedurë tjetër në pajtim me nenin 287 për qëllimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve që rrjedhin nga kjo Konventë.

**5.** Një Shtet Palë në këtë Konventë që nuk është palë në konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtën e detit, në momentin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë Konventë ose në çdo kohë pas kësaj është i lirë të zgjedhë, me anë të një deklaratë me shkrim, një ose më shumë nga mjetet e parashikuara në nenin 287, paragrafi 1 i konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtën e detit për qëllimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas këtij neni. Neni 287 zbatohet për këtë deklaratë, si dhe për çdo mosmarrëveshje tek e cila ky shtet është palë, që nuk mbulohet nga një deklaratë në fuqi. Për qëllimin e pajtimit dhe arbitrazhit, në pajtim me anekset V dhe VII të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të drejtën e detit, ky shtet ka të drejtën të emërojë ndërmjetës ose arbitra për t'u përfshirë në listat e përmendura në aneksin V, neni 2 dhe aneksin VII, neni 2 për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që rrjedhin nga kjo Konventë.

## **Neni 26**

### **Ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi**

**1.** Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit nga shtetet anëtare të UNESCO-s.

**2.** Kjo Konventë është e hapur për aderim:

a) nga shtetet që nuk janë anëtare të UNESCO-s, por janë anëtare të Kombeve të Bashkuara ose të një agjencie të specializuar brenda sistemit të Kombeve të Bashkuara ose të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike, si dhe nga Shtetet Palë në Statutin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe çdo shtet tjetër i ftuar për të aderuar në këtë Konventë nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s;

b) nga territoret që gëzojnë vetëqeverisje të brendshme, e njohur si e tillë nga Kombet e Bashkuara, por që nuk kanë arritur pavarësinë e plotë në pajtim me rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 1514 (XV) dhe që ka kompetencë mbi çështjet e rregulluara nga kjo Konventë, duke përfshirë kompetencën për të hyrë në traktate në lidhje me këto çështje.

**3.** Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit depozitohen te Drejtori i Përgjithshëm.

## **Neni 27**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo Konventë hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të njëzetë të përmendur në nenin 26, por vetëm në lidhje me njëzet shtetet ose territoret që kanë depozituar instrumentet e tyre. Ajo hyn në fuqi për çdo shtet ose territor tjetër tre muaj pas datës në të cilën ai shtet ose territor ka depozituar instrumentin e tij.

## **Neni 28**

### **Deklarimi për ujërat e brendshme**

Në momentin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit të kësaj Konvente ose në çdo moment pas këtij, çdo shtet ose territor mund të deklarojë që rregullat zbatohen për ujërat e brendshme jo të një natyre detare.

## **Neni 29**

### **Kufizimet e objektit gjeografik**

Në momentin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë Konventë, një shtet ose territor mund ta bëjë një deklaratë te depozitari që kjo Konventë nuk do të jetë e zbatueshme në pjesë të caktuara të territorit, ujërave të brendshme, ujërave arkipelagjike ose detin e tij territorial dhe identifikon në të shkaqet për një deklaratë të tillë. Ky shtet, në masën që është praktike dhe menjëherë sapo të jetë e mundur, nxit kushtet sipas të cilave zbatohet kjo Konventë në zonat e përcaktuara në deklaratën e tij dhe për këtë qëllim tërheq gjithashtu deklaratën e tij plotësisht ose pjesërisht menjëherë sapo ajo të jetë arritur.

## **Neni 30**

### **Rezervat**

Me përjashtim të nenit 29, kësaj Konvente nuk mund t'i bëhet asnjë rezervë.

## **Neni 31**

### **Ndryshimet**

1. Një Shtet Palë, me komunikim me shkrim drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, mund të propozojë ndryshime në këtë Konventë. Drejtori i Përgjithshëm e qarkullon këtë komunikim te të gjitha Shtetet Palë. Nëse, brenda gjashtë muajve nga data e qarkullimit të komunikimit, jo më pak se gjysma e Shteteve Palë përgjigjen pozitivisht ndaj kërkesës, Drejtori i Përgjithshëm e paraqet këtë propozim në mbledhjen e radhës të Shteteve Palë për diskutim dhe miratim të mundshëm.



2. Ndryshimet miratohen nga një shumicë prej dy të tretave të Shteteve Palë të pranishme dhe që votojnë.

3. Pas miratimit, ndryshimet e Konventës i nënshtrohen ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit nga Shtetet Palë.

4. Ndryshimet hyjnë në fuqi, por vetëm për Shtetet Palë që kanë ratifikuar, pranuar, miratuar ose aderuar në to, tre muaj pas depozitimit të instrumenteve të përmendur në paragrafin 3 të këtij neni me dy të tretat e Shteteve Palë. Pas kësaj, për çdo shtet ose territor që e ratifikon, pranon, miraton ose aderon në të, ndryshimi hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit nga ajo palë të instrumentit të saj të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

5. Një shtet ose territor që bëhet palë në këtë Konventë ose pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni, nëse mungon shprehja e një qëllimi të ndryshëm nga ai shtet ose territor, konsiderohet:

a) Palë në Konventën e ndryshuar; dhe

b) Palë në Konventën e pandryshuar në lidhje me çdo Shtet Palë që nuk i nënshtrohet ndryshimit.

## **Neni 32**

### **Denoncimi**

1. Një Shtet Palë e denoncon këtë Konventë me njoftim me shkrim drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm.

2. Denoncimi hyn në fuqi dymbëdhjetë muaj pas datës së marrjes së njoftimit, përveçse kur njoftimi përcakton një datë të mëvonshme.

3. Denoncimi nuk cenon në asnjë mënyrë detyrën e çdo Shteti Palë për të përmbushur çdo detyrim të parashikuar nga kjo Konventë të cilit do t'i nënshtrohej në pajtim me të drejtën ndërkombëtare pavarësisht nga kjo Konventë.

## **Neni 33**

### **Rregullat**

Rregullat bashkëngjitur kësaj Konvente përbëjnë një pjesë integrale të saj dhe, nëse nuk parashikohet shprehimisht ndryshe, një referencë në këtë Konventë përfshin një referencë të rregullat.

## Neni 34

### Regjistrimi te Kombet e Bashkuara

Në pajtim me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, kjo Konventë regjistrohet te sekretariati i Kombeve të Bashkuara me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm.

## Neni 35

### Tekstet autentike

Kjo Konventë është hartuar në gjuhën arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle, dhe të gjashtë tekstet janë njëloj autentike.

## ANEKS

### RREGULLAT NË LIDHJE ME AKTIVITETET DREJTUAR NDAJ TRASHËGIMISË KULTURORE NËNUJORE

#### I. Parime të përgjithshme

**Rregulli 1.** Mbrojtja e trashëgimisë kulturore nënujore nëpërmjet ruajtjes in situ konsiderohet si opsion i parë. Përkatësisht, aktivitetet drejtuar ndaj trashëgimisë kulturore nënujore autorizohen në një mënyrë në pajtim me mbrojtjen e asaj trashëgimie dhe në pajtim me këtë kërkesë mund të jepet autorizimi me qëllim dhënien e një kontributi të rëndësishëm për mbrojtjen ose njohurinë, ose rritjen e trashëgimisë kulturore nënujore.

**Rregulli 2.** Shfrytëzimi tregtar i trashëgimisë kulturore nënujore për tregtim ose spekulim apo shpërndarja e saj e pakthyeshme është katërcipërisht në kundërshtim me mbrojtjen dhe menaxhimin e rregullt të trashëgimisë kulturore nënujore. Trashëgimia kulturore nënujore nuk tregtohet, shitet, blihet ose këmbehet si mall në treg.

Rregulli nuk mund të interpretohet sikur pengon:

a) dhënien e shërbimeve profesionale arkeologjike ose shërbimeve të nevojshme për t'u dhënë, natyra dhe qëllimi i të cilave është në përputhje të plotë me Konventën dhe i nënshtrohen autorizimit të autoriteteve kompetente;

b) depozitimin e trashëgimisë kulturore nënujore, të përftuar në kontekstin e një projekti kërkimor në pajtim me këtë Konventë, me kusht që një depozitim i tillë të mos cenojë interesin shkencor ose kulturor, ose integritetin e materialit të përftuar ose të rezultojë në shpërndarje të pakthyeshme; të jetë në pajtim me dispozitat e rregullave 33 dhe 34; dhe t'i nënshtrohet autorizimit të autoriteteve kompetente.

**Rregulli 3.** Aktivitetet e drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore nuk ndikojnë negativisht në trashëgiminë kulturore nënujore më shumë nga sa është e nevojshme për objektivat e projektit.

**Rregulli 4.** Aktivitetet e drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore duhet të përdorin teknika joshkatërruese dhe metodat e vrojtimit dhe jo të përfutimit të objekteve. Nëse është i nevojshëm gjurmimi ose përfutimi për qëllimin e studimeve shkencore ose për mbrojtjen përfundimtare të trashëgimisë kulturore nënujore, metodat dhe teknikat e përdorura duhet të jenë sa më pak shkatërruese që të jetë e mundur dhe të kontribuojnë në ruajtjen e pjesëve të mbetura.

**Rregulli 5.** Aktivitetet e drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore shmangin ndërhyrjet e panevojshme të mbetjet njerëzore ose vendet e nderuara.

**Rregulli 6.** Aktivitetet e drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore rregullohen rigorozisht për të siguruar regjistrimin e përshtatshëm të informacionit kulturor, historik dhe arkeologjik.

**Rregulli 7.** Hyrja publike në trashëgiminë kulturore nënujore in situ nxitet, me përjashtim të rasteve kur kjo hyrje është në kundërshtim me mbrojtjen dhe menaxhimin.

**Rregulli 8.** Bashkëpunimi ndërkombëtar në zhvillimin e aktiviteteve të drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore inkurajohet me qëllim nxitjen e shkëmbimit ose përdorimit të efektshëm të arkeologëve dhe profesionistëve të tjerë përkatës.

## **II. Disenjoja e projektit**

**Rregulli 9.** Para çdo aktiviteti të drejtuar ndaj trashëgimisë kulturore nënujore, përpilohet një disenjo projekti për aktivitetin dhe u paraqitet autoriteteve kompetente për autorizimin dhe studimin e përshtatshëm.

**Rregulli 10.** Disenjoja e projektit përfshin:

- a) një vlerësim të studimeve të mëparshme ose paraprake;
- b) deklarin dhe objektivat e projektit;
- c) metodologjinë që përdoret dhe teknikat që zbatohen;
- d) financimin e parashikuar;
- e) një afat të pritshëm kohor për përfundimin e projektit;
- f) përbërjen e ekipit dhe kualifikimet, përgjegjësitë dhe eksperiencën e secilit anëtar të ekipit;
- g) planet për analizat pas punës në terren dhe aktivitetet e tjera;

- h) një program konservimi për veglat parahistorike dhe vendin në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet kompetente;
- i) një politikë për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e vendit për të gjithë kohëzgjatjen e projektit;
- j) një program dokumentimi;
- k) një politikë sigurie;
- l) një politikë për ambientin;
- m) masat për bashkëpunimin me muzetë dhe institucionet e tjera, në institucione të veçanta shkencore;
- n) përgatitjen e raportit;
- o) depozitimin e arkivave, duke përfshirë trashëgiminë kulturore nënujore të hequr; dhe
- p) një program publikimi.

**Rregulli 11.** Aktivitetet e drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore zhvillohen në pajtim me disenjon e projektit të miratuar nga autoritetet kompetente.

**Rregulli 12.** Nëse bëhen zbulime të papritura ose ndryshojnë rrethanat, disenjoja e projektit rishikohet dhe ndryshohet me miratimin e autoriteteve kompetente.

**Rregulli 13.** Në rastet e urgjencës ose zbulimeve të rastësishme, aktivitetet e drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore, duke përfshirë masat e konservimit ose aktivitetet për një periudhë kohëzgjatjeje të shkurtër, veçanërisht stabilizimi i vendeve, mund të autorizohen në mungesë të një disenjoje projekti me qëllim që të mbrohet trashëgimia kulturore nënujore.

### **III. Puna paraprake**

**Rregulli 14.** Puna paraprake e përmendur në rregullin 10 (a) përfshin një vlerësim që mat rëndësinë dhe prekshmërinë e trashëgimisë kulturore nënujore dhe ambientit natyror rrethues nga dëmtimi nëpërmjet projektit të propozuar dhe mundësinë për të marrë të dhëna që do të përbushnin objektivat e projektit.

**Rregulli 15.** Vlerësimi përfshin gjithashtu studime paraprake mbi provat ekzistuese historike dhe arkeologjike, karakteristikat arkeologjike dhe ambientaliste të vendit dhe pasojat e çdo ndërhyrjeje të mundshme për stabilitetin afatgjatë të trashëgimisë kulturore nënujore të ndikuar nga aktivitetet.

#### **IV. Objektivi, metodologjia dhe teknikat**

**Rregulli 16.** Metodologjia përputhet me objektivat e projektit dhe teknikat e zbatuara do të jenë sa më pak dëmtuese që të jetë e mundur.

#### **V. Financimi**

**Rregulli 17.** Përveçse në rastet e emergjencës për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore nënujore, sigurohet një bazë e përshtatshme financimi për çdo aktivitet, e mjaftueshme për të përmbushur të gjitha fazat e disenjës së projektit, duke përfshirë konservimin, dokumentimin dhe ndreqjen e veglave të punës të gjetura, përgatitjen dhe shpërndarjen e raportit.

**Rregulli 18.** Disenjoja e projektit demonstroi një aftësi, si sigurimi i një obligacioni, për ta financuar projektin deri në fund.

**Rregulli 19.** Disenjoja e projektit përfshin një plan emergjence që do të sigurojë konservimin e trashëgimisë kulturore nënujore dhe dokumentacionin mbështetës në rastin e çdo ndërprerjeje të financimit të planifikuar.

#### **VI. Kohëzgjatja e projektit - grafiku kohor**

**Rregulli 20.** Një grafik kohor i përshtatshëm zhvillohet për të siguruar para çdo aktiviteti të drejtuar ndaj trashëgimisë kulturore nënujore përfundimin e të gjitha fazave të disenjës së projektit, duke përfshirë konservimin, dokumentimin dhe ndreqjen e trashëgimisë kulturore nënujore të përfutur, si dhe përgatitjen dhe shpërndarjen e raportit.

**Rregulli 21.** Disenjoja e projektit përfshin një plan emergjence që do të sigurojë konservimin e trashëgimisë kulturore nënujore dhe dokumentacionin mbështetës në rastin e ndërprerjes ose mospërfundimit të projektit.

#### **VII. Aftësitë dhe kualifikimet**

**Rregulli 22.** Aktivitetet e drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore ndërmerren vetëm nën drejtimin dhe kontrollin, si dhe në praninë e përshtatshme të arkeologut të kualifikuar nënujor me aftësi shkencore të përshtatshme për projektin.

**Rregulli 23.** Të gjithë personat e ekipit të projektit janë të kualifikuar dhe kanë aftësi të demonstruara, të përshtatshme për rolet e tyre në projekt.

#### **VIII. Konservimi dhe menaxhimi i vendit**

**Rregulli 24.** Programi i konservimit parashikon trajtimin e mbetjeve arkeologjike gjatë aktiviteteve të drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënuj ore, përkohësisht dhe në një afat të gjatë. Konservimi kryhet në pajtim me standardet e tashme profesionale.

**Rregulli 25.** Programi i menaxhimit të vendit parashikon mbrojtjen dhe menaxhimin in situ të trashëgimisë kulturore nënujore, gjatë dhe me përfundimin e punës në terren. Programi përfshin informacionin publik, parashikim të arsyeshëm për stabilizimin e vendit, monitorimin dhe mbrojtjen nga ndërhyrjet.

## **IX. Dokumentimi**

**Rregulli 26.** Programi i dokumentimit parashikon dokumentim të hollësishëm duke përfshirë një raport progresi të aktiviteteve të drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore, në pajtim me standardet e tashme profesionale të dokumentimit arkeologjik.

**Rregulli 27.** Dokumentimi përfshin, minimalisht, një regjistrim të plotë të vendit, duke përfshirë origjinën e trashëgimisë kulturore nënujore të lëvizur ose të hequr gjatë aktiviteteve të drejtuara ndaj trashëgimisë kulturore nënujore, shënime të terrenit, plane, skica, seksione dhe fotografi apo regjistrim në mjete të tjera.

## **X. Siguria**

**Rregulli 28.** Përpilohet një politikë sigurie që është e përshtatshme të garantojë sigurinë dhe shëndetin e ekipit të projektit dhe palëve të treta dhe që është në pajtim me çdo kërkesë të zbatueshme statusore dhe profesionale.

## **XI. Ambienti**

**Rregulli 29.** Përpilohet një politikë ambienti që është e përshtatshme për të garantuar që jeta e shtratit të detit dhe detare të mos cenohen në mënyrë të papërshtatshme.

## **XII. Raportimi**

**Rregulli 30.** Raporte të përkohshme dhe përfundimtare jepen në pajtim me grafikun kohor të parashikuar në disenjon e projektit dhe të depozituar në regjistrat përkatës publikë.

**Rregulli 31.** Raportet përfshijnë:

- a) një përshkrim të objektivave;
- b) një përshkrim të metodave dhe teknikave të zbatuara;
- c) një përshkrim të rezultateve të arritura;
- d) dokumentacion bazë grafik dhe fotografik për të gjitha fazat e aktivitetit;
- e) rekomandime në lidhje me konservimin dhe rregullimin e vendit dhe të çdo trashëgimie kulturore nënujore të hequr; dhe
- f) rekomandimet për aktivitete të ardhshme.

### **XIII. Rregullimi i arkivave të projektit**

**Rregulli 32.** Për masat për rregullimin e arkivave të projektit bihet dakord para fillimit të çdo aktiviteti dhe këto përcaktohen në disenjon e projektit.

**Rregulli 33.** Arkivat e projektit, duke përfshirë trashëgiminë kulturore nënujore të hequr dhe një kopje të gjithë dokumentacionit shoqërues, në masën që është e mundur, mbahen së bashku dhe të paprekur si një koleksion në një mënyrë që të jetë e përshtatshme për akses profesional dhe publik, si dhe për rregullimin e arkivave. Kjo duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se dhjetë vjet nga përfundimi i projektit, në masën që mund të jetë në përputhje me konservimin e trashëgimisë kulturore nënujore.

**Rregulli 34.** Arkivat e projektit menaxhohen në pajtim me standardet profesionale ndërkombëtare dhe në bazë të autorizimit nga autoritetet kompetente.

### **XIV. Shpërndarja**

**Rregulli 35.** Projektet parashikojnë edukim publik dhe bërjen publike të rezultateve të projektit, sipas rastit.

**Rregulli 36.** Një përmbledhje përfundimtare e një projekti:

a) bëhet publike sa më shpejt të jetë e mundur, duke i kushtuar rëndësi kompleksitetit të projektit dhe natyrës konfidenciale dhe sensitive të informacionit; dhe

b) depozitohet te regjistrat përkatës publikë.

Bërë në Paris, më 6 nëntor 2001 në dy kopje autentike, të nënshkruara nga kryetari i sesionit të tridhjetenjë të Konferencës së Përgjithshme dhe Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës Arsimore, Shkencore dhe Kulturore të Kombeve të Bashkuara, që do të depozitohen në arkivat e Organizatës Arsimore, Shkencore dhe Kulturore të Kombeve të Bashkuara dhe kopje të vërtetuara të të cilave do t'u jepen të gjitha shteteve dhe territoreve të përmendura në nenin 26, si dhe Kombeve të Bashkuara.

Teksti zyrtar: anglisht, frëngjisht

Anglisht

Frëngjisht

Spanjisht

Rusisht

Gjuha kineze

Arabisht

**Data e miratimit 2001**

Deklarata dhe rezerva